



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 102

Tiranë – E hënë, 15 korrik 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11218, datë 4.7.2019	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 7477
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 10.7.2019	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (marrësi), Bashkisë Tiranë (Agjencia Zbatuese e Projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për shërbimet e ekspertit ndaj agjencisë zbatuese të projektit, në kuadër të projektit të transportit të gjelbër në Tiranë, që financohen nga një fond i veçantë i siguruar nga qeveria Federale Gjermane..... 7477
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 492, datë 10.7.2019	Për miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, për vitin shkollor 2019–2020..... 7487
Udhëzim i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4, datë 28.6.2019	Për dokumentet për qarkullim dhe regjistrim të mjeteve rrugore..... 7488
Udhëzim i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 19, datë 9.7.2019	Për mbikëqyrjen e organizatave jofitimprurëse në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” 7501
Kërkesë e Ministrisë së Mbrojtjes nr. 4424/2, datë 4.7.2019	Për shpronësim, “Për zbatimin e ligjit nr. 10256, datë 25.3.2010 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë “Për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”..... 7506

Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 5068/4, datë 8.7.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Sistemimi i sheshit pas pallatit nr. 23”, Lushnjë.....	7508
Njoftim i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme nr. 9852, datë 4.7.2019	Për hyrje në fuqi të marrëveshjes.....	7508

**DEKRET**

Nr. 11218, datë 4.7.2019

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Dorina Bardhyl Lleshi (Hoxha)
2. Nevila Fahri Quaas (Kraja)
3. Suela Besnik Barbullushi
4. Aurora Agron Dunda
5. Arian Telha Shehu
6. Aurora Arian Shehu
7. Afrim Ibrahim Mena
8. Jennifer Andi Alizoti
9. Ervis Robert Tafa
10. Darko Sllobodan Raiçeviq
11. Eniada Lulëzim Meta
12. Vernida Ibrahim Adili

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM

Nr. 481, datë 10.7.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE EKONOMISË
(MARRËSI), BASHKISË TIRANË
(AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT),
DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW),
PËR SHËRBIMET E EKSPERTIT NDAJ
AGJENCISË ZBATUESE TË PROJEKTIT,
NË KUADËR TË PROJEKTIT TË
TRANSPORTIT TË GJELBËR NË
TIRANË, QË FINANCOHEN NGA NJË
FOND I VEÇANTË I SIGURUAR NGA
QEVERIA FEDERALE GJERMANE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrësi), Bashkisë Tiranë (Agjencia zbatuese e projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për shërbimet e ekspertit ndaj agjencisë zbatuese të projektit, në kuadër të projektit të transportit të gjelbër në Tiranë, që financohen nga një fond i veçantë i siguruar nga qeveria Federale Gjermane, me një grant në shumën 1 670 000 (një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**MARRËVESHJE FINANCIMI****Datë 3.6.2019**

**NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM
MAIN (“KfW”) DHE REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË (“MARRËSI”) DHE
BASHKISË TIRANË (“AGJENCIA
ZBATUESE E PROJEKTIT”)**

për
EUR 1,670,000.00

Për Shërbimet e Ekspertit ndaj Agjencisë Zbatuese të Projektit në kuadrin e Projektit të Transportit të Gjellbër në Tiranë, që financohet nga një fond i veçantë (Studien und Beratungsfonds) nr. 20239 siguruar nga Qeveria Federale Gjermane.

Përmbajtja

Neni 1	Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar
Neni 2	Transferimi i kontributit financiar tek
Neni 3	Agjencia Zbatuese e Projektit
Neni 4	Disbursimi
Neni 5	Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja
Neni 6	Kostot dhe detyrimet publike
Neni 7	Deklarimet kontraktuale dhe
Neni 8	kompetencat e përfaqësimit
Neni 9	Shërbimet e Ekspertit
Neni 10	Shërbimet e Konsulentit
Aneksi 1 (a)	Publikimi dhe transferimi i informacionit
Aneksi 1 (b)	që ka lidhje me shërbimet e Ekspertit
	Dispozita të ndryshme
	Angazhime të pajtueshmërisë të Marrësit
	Angazhime të pajtueshmërisë të
	Agjencisë Zbatuese të Projektit

Në bazë të autorizimit të dhënë nga Qeveria Federale Gjermane datë 9 korrik 2018 dhe kërkesës së Agjencisë Zbatuese të Projektit, me mbështetjen e Marrësit, Marrësi, Agjencia Zbatuese e Projektit dhe KfW lidhin Marrëveshjen e Financimit si vijon:

Neni 1**Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar**

1.1 KfW do t'i japë Marrësit një kontribut financiar deri në

EUR 1,670,000.00
("Kontributi Financiar").

Ky kontribut financiar nuk është i shlyeshëm, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi do të vendosë kontributin e plotë financiar në dispozicion të Agjencisë Zbatuese të Projektit në përputhje me kushtet e parashtruara në nenin 2. Agjencia Zbatuese e Projektit do të përdorë kontributin financiar ekskluzivisht për financimin e shërbimeve të ekspertit si vijon:

Përgatitja e një studimi fizibiliteti për një sistem transporti publik në Tiranë, Shqipëri ("Shërbimet e Ekspertit").

1.3 Agjencia Zbatuese e Projektit do të japë kontributet e saj plotësuese në mënyrë të plotë dhe në kohën e duhur. Agjencia Zbatuese e Projektit do t'i japë KfW-së, në vijim të kërkesës së saj, evidencë që vërteton masat e marra në këtë drejtim.

1.4 Tatimet dhe taksat e tjera publike të cilat i lindin Marrësit ose Agjencisë Zbatuese të Projektit, si dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga Kontributi Financiar.

Neni 2

**Transferimi i kontributit financiar tek
Agjencia Zbatuese e Projektit**

2.1 Marrësi do të transferojë kontributin financiar tek Agjencia Zbatuese e Projektit si një grant i pakthyeshëm nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi financiar, Marrësi do t'i japë KfW-së një kopje ose një përkthim të certifikuar në gjuhën gjermane ose angleze të marrëveshjes së referuar në nenin 2.1.

2.3 Transferimi i kontributit financiar nuk do të përbëjë asnjë përgjegjësi të Agjencisë Zbatuese të Projektit kundrejt KfW-së, për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3**Disbursimi**

3.1 Marrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit autorizon këtu KfW-në për të kryer parapagime, pagesa të përkohshme dhe përfundimtare nga kontributi financiar për Konsulentin (siç përcaktohet në nenin 7.1 a). Këto pagesa do të kryhen në përputhje me



ecurinë e Shërbimeve të Ekspertëve mbi bazën e faturave origjinale të paraqitura tek KfW (kopje për Agjencinë Zbatuese të Projektit) dhe në përputhje me kontratat që duhet të lidhen ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe Konsulentit (“Kontrata e Konsulencës”). Ky autorizim nga Marrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit do të konsiderohet se është një kërkesë për disbursim për të gjitha pagesat e përmendura më sipër. Marrësi që vepron nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit mund t’i kërkojë KfW-së, duke bërë një kërkesë me shkrim, të pezullojë pagesat nga kontributi financiar.

3.2 Për pagesat e kryera në një monedhë të ndryshme nga ajo e përcaktuar (“monedhë e huaj”), KfW-ja do të debitojë Marrësin me një shumë të tillë në euro, siç është shpenzuar nga KfW për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet rastësore.

3.3 KfW-ja nuk do të jetë përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga transferimi i institucioneve bankare në disbursimin ose dërgesat e çfarëdo pagese nga ana e KfW-së. Nëse shkaktohet ndonjë vonesë nga KfW-ja, përgjegjësia e saj do të kufizohet në pagesën e interesit të akumuluar.

3.4 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30.6.2021.

3.5 Kontrata e konsulencës do përfshijë një dispozitë që përcakton se çdo rimbursim, garanci ose pagesë e ngjashme që kërkohet dhe çdo pagesë siguracioni, do kryhet për llogari të Marrësit tek KfW, Frankfurt am Main, IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00, BIC: KFWIDEFF, dhe KfW-ja do kreditojë pagesa të tilla në llogarinë e Marrësit.

Neni 4

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet përveç rasteve kur:

a) marrësi dështon në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur ato duhet të kryhen;

b) detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje janë shkelur;

c) Agjencia Zbatuese e Projektit nuk mund të vërtetojë se shumatat e disbursuara janë përdorur të gjitha për qëllimin e paracaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) lindin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e shërbimeve të ekspertëve; ose

f) Kontrata e konsulencës është shkelur, ka përfunduar ose është pezulluar.

4.2 Nëse cilado nga situatat e specifikuar në nenin 4.1 b), c), ose d) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë do jetë të paktën 30 ditë, atëherë KfW-ja:

a) në rastet e specifikuar në nenin 4.1 b), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara; në rastin e nenit 4.1 d) mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave, pagesa e të cilave tek Marrësi ose lënia me Marrësin përbën shkelje të ligjit të zbatueshëm;

b) në rastet e specifikuar në nenin 4.1 c), mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të shumave për të cilat Agjencia Zbatuese e Projektit nuk mund të vërtetojë se janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Neni 5

Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që akumulohen jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe koston e transfertave dhe koston e konvertimit të shkaktuar në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6

Deklarimet kontraktuale dhe kompetencat e përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe ata persona të caktuar prej tij ose saj, kundrejt KfW-së dhe autorizohen nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë Marrësin në zbatimin e kësaj



Marrëveshjeje. Kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe ata persona që caktohen prej tij ose kundrejt për KfW-së dhe autorizohen nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj, do përfaqësojnë Agjencinë Zbatuese të Projektit në ekzekutimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Kompetencat e përfaqësimit nuk skadojnë derisa të jetë marrë prej KfW-së anulimi shprehimisht nga përfaqësuesit e autorizuar për atë kohë.

6.2 Çdo ndryshim apo shtesë dhe çdo njoftim apo deklaratë nga palët kontraktuese në këtë Marrëveshje duhet të bëhet me shkrim. Ministri i Financave dhe Ekonomisë autorizohet të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që cenon vetëm periudhën e vlefshmërisë (neni 3.4) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë do të konsiderohet e marrë sapo të ketë mbërritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese apo në ndonjë adresë tjetër të palës kontraktuese sipas njoftimit të bërë palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në	KfW Postfach 11 11 41 60046 Frankfurt am Main Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë) Faks: +49 69 7431-2944
Për Marrësin:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 3 Tiranë
Për Agjencinë Zbatuese të Projektit:	Bashkia e Tiranës Sheshi “Skënderbej”, nr. 2, Kodi postar 1001, Tirana

6.3 Ndryshimet në këtë Marrëveshje që prekin vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-së dhe Marrësit nuk do të kërkojnë miratimin e Agjencisë Zbatuese të Projektit.

Neni 7

Shërbimet e Ekspertëve

7.1 Agjencia Zbatuese e Projektit

a) do i caktojë Shërbimet e Ekspertit konsulentëve të pavarur të kualifikuar (“Konsulentit”) me praktika të qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, në përputhje me

standardet mjedisore dhe sociale dhe në thelb, në përputhje me konceptin e projektit tëndakordësuar ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe KfW-së për Shërbime Ekspertësh;

b) në vijim të parapërzgjedhjes dhe tenderimit konkurrues ndërkombëtar publik, do t’i japë kontratën e konsulencës një Konsulentit të kualifikuar të pavarur. Procedura për Dhënien e kontratës së konsulencës do të zbatohet sipas “Udhëzimeve për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim” (versioni janar 2019 sikundër publikuar në faqen e KfW-së në datën e kësaj marrëveshjeje)¹.

Për këtë qëllim, KfW-së do t’i jepet në kohën e duhur drafti i Kontratës së Konsulencës, dokumentet për kualifikimet e ekspertëve të zgjedhur dhe i gjithë dokumentacioni tjetër i duhur, sipas kërkesës së KfW-së;

c) do ruajë, ose do marrë masa për ruajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e pësura në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe që identifikojnë në mënyrë të qartë shërbimet e financuara nga Kontributi Financiar;

d) do i mundësojë përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrimet e përmendura dhe të gjithë dokumentacionin tjetër të përshtatshëm për zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve;

e) do i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për Shërbimet e Ekspertëve dhe për ecurinë e tyre të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së;

f) do komentojë për raportet e Konsulentit ose do njoftojë miratimin e tij për përmbajtjen duke nënshkruar raportet dhe

g) do marrë vendimet e saj për të gjitha skicat, raportet, studimet dhe zëvendësimin e anëtarëve të stafit të Konsulentit në marrëveshje me KfW-në.

7.2 Marrësi, nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, do të sigurojë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertëve dhe me kërkesë të KfW-së, do t’i japë KfW-së prova që vërtetojnë se kostot që nuk janë paguar nga ky kontribut financiar, janë të mbuluara;

¹ <https://www.kfw-entwicklungsbank.de/PDF/Download-Center/PDF-Dokumente-Richtlinien/Vergaberichtlinien-2019-Englisch-Internet-2.pdf>



7.3 Marrësi dhe Agjencia Zbatuese të Projektit, me pëlqimin e tyre, do informojnë menjëherë KfW-në për të gjitha rrethanat që parandalojnë ose rrezikojnë në mënyrë serioze zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve ose qëllimin e tyre.

7.4 Marrësi do asistojë Agjencinë Zbatuese të Projektit në përputhje me praktikën e mira inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve dhe në realizimin e detyrimeve të Agjencisë Zbatuese të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në mënyrë të veçantë, do t'i mundësojë Agjencisë Zbatuese të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve, nëse ka, ose do mbështesë Agjencinë Zbatuese të Projektit me marrjen e lejeve të tilla.

7.5 Menjëherë pas përfundimit të Shërbimeve të porositura të Ekspertëve, KfW-ja do të pajiset me një numër kopjesh të të gjitha skicave, raporteve, studimeve të përgatitura nga Konsulenti, sipas kërkesës së KfW-së. KfW-ja mund të ketë bërë vlerësimin e studimeve të përmendura.

7.6 Nga financimi i Shërbimeve të Ekspertëve, as Marrësit, as Agjencisë Zbatuese të Projektit nuk mund t'i lindë asnjë e drejtë për financimin nga KfW të projektit të përgatitur nga Shërbimet e Ekspertëve. Marrësi dhe Agjencia Zbatuese e Projektit, megjithatë, i japin Republikës Federale të Gjermanisë një mundësi për të financuar projektin sipas Bashkëpunimit Financiar.

Neni 8

Shërbimet e Konsulentit

8.1 Detyrat e Konsulentit do të përfshijnë sa vijojnë:

- Konsulenti do të grumbullojë dhe analizojë të gjitha studimet dhe dokumentacionin e disponueshëm në lidhje me Projektin, do të kryejë një vlerësim të plotë të situatës ekzistuese të korridoreve që duhen përcaktuar, duke përfshirë studimet paraprake inxhinierike dhe gjeoteknike dhe përpunimin e diskutimit të një koncepti zhvillimi për një Sistem Transporti Publik bazuar në BRT (Tranzit Autobus i Shpejtë), në Tiranë.

- Konsulenti do të vlerësojë fizibilitetin e një sistemi Tranzit Autobus i Shpejtë për sa i takon çështjeve teknike, financiare, ekonomike, mjedisore dhe sociale, ligjore dhe institucionale dhe operacionale në korridoret që do të përcaktohen;

- Konsulenti do zhvillojë projekte të kërkesës së transportit përgjatë korridoreve që do përcaktohen, në kontekstin e rrjetit të tyre, për hapësira kohore të ndryshme, duke modeluar trafikun bazuar në të dhënat e studimeve të transporteve dhe trendin rritës në zonën e influencës së projektit. Projektet do përfshijnë ndikimet e projekteve të siguruara dhe potenciale të transportit dhe zhvillimit.

8.2 KfW-ja do zotërojë të drejtën e pakufizuar për të përdorur dhe shfrytëzuar rezultatet e Shërbimeve të Ekspertëve dhe të gjitha dokumentet që lidhen me to, të financuara nga ky Kontribut Financiar gjatë gjithë kohës dhe në të gjitha vendndodhjet sipas zgjedhjes së saj.

Neni 9

Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me Shërbimet e Ekspertit

9.1 Në përputhje me parimet e pranuar ndërkombëtarisht të transparencës maksimale dhe efikasitetit në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacion të përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) rreth Shërbimeve të Ekspertëve dhe se si financohen ato gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa marrëveshja/et në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve - është\janë duke u zbatuar dhe në fazën pas kontraktimit (këtu e tutje referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet periodikisht në faqen e KfW-së për fushën e saj të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (“KfW Development Bank”) (<http://transparenz.kfw-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 9.3 më poshtë) për Shërbimet e Ekspertëve dhe si ata financohen nuk përfshin dokumentacionin kontraktual ose ndonjë informacion sensitiv financiar apo informacion sensitiv biznesi për palët e përfshira në Shërbimet e Ekspertëve ose në financimin e tij, të tilla si:



- a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;
- b) strategji biznesi;
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme korporative;
- d) të dhëna personale të personave fizikë;
- e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

9.2 KfW-ja ndan informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën sesi ato financohen gjatë të gjithë periudhës me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

- a) filialet e KfW-së;
- b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;
- c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin dypalësh gjerman për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;
- d) organizatat ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarë të tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe anëtarët e saj.

9.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacion të përzgjedhur në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe se si ato financohen gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat botojnë paragrafët që kanë lidhje me qëllimin:

- a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllime të Iniciativës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare (http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/weg_e/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);
- b) Tregu dhe Investimi Gjerman (GTAI) për qëllime të informacionit të tregut (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/tra.de.FOO>);
- c) OECD për qëllimin e raportimit të rrjedhës financiare në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit (<http://stats.oecd.org/>);
- d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllime të vlerësimit të zhvillimit të përgjithshëm të bashkëpunimit

Gjerman për të garantuar transparencën dhe eficiencën (<http://www.deval.org/de/>).

9.4 Gjithashtu, KfW-ja rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve dhe sesi ato financohen gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Marrësit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. interesat e ligjshme të Marrësit në veçanti përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 9.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve, ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

Neni 10

Dispozita të Ndryshme

10.1 Marrësi zotohet të jetë në përputhje gjatë gjithë kohës me detyrimet e parashtruara në Aneksin 1 a (Angazhime të Pajtuëshmërisë për Marrësin). Agjencia Zbatuese e Projektit ndërmerr që të jetë në përputhje gjatë gjithë kohës me detyrimet e parashtruara në Aneksin 1 b (Angazhime të Pajtuëshmërisë për Agjencinë Zbatuese të Projektit).

10.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rezultojë prej kësaj do të plotësohet me një dispozitë në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

10.3 Marrësi nuk mund të kalojë, transferojë, rëndojë me peng apo hipotekë asnjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

10.4 Kjo Marrëveshjeje do të rregullohet nga ligjet e Republikës Federale Gjermane. Vendi i zbatimit do të jetë Frankfurt am Main. Marrëdhëniet ligjore të vendosura ndërmjet KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë Zbatuese të



Projektit do të përfundojnë gjashtë vjet pas disbursimit të fundit.

10.5 Kjo Marrëveshje Financimi do të hyjë në fuqi pasi KfW të ketë marrë njoftim me shkrim nga Marrësi se të gjitha procedurat e brendshme ligjore për t'u përmbushur nga Marrësi janë realizuar.

Përgatitur në 3 (tri) origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, më 3.6.2019

Tiranë
më 3.6.2019

KfW
Republika e Shqipërisë
përfaqësuar nga Ministria
e Financave dhe
Ekonomisë

Më 30.5.2019
Bashkia Tiranë

Anekset

Aneksi 1a: Angazhime të Pajtueshmërisë për Marrësin

Aneksi 1b: Angazhime të Pajtueshmërisë për Agjencinë Zbatuese të Projektit

ANEKSI 1A ANGAZHIME TË PAJTUESHMËRISË SË MARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

Praktika shtrënguese: dëmtimi ose cenimi, ose kërcënimi për të dëmtuar ose cënuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person ose pasuri të personit me qëllim që të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme veprimet e një personi.

Praktika e fshehtë: një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e cila hartohet për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

Praktika korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çdo natyre, për ose nga cilitdo person, me qëllim ndikimin e veprimeve të çdo personi ose shkaktimin e përmbytjes së çfarëdo personi nga çfarëdo veprimi.

Praktika mashtruese: çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin, që

me vetëdije ose pakujdesi mashtron ose përpiket të mashtrorë një person për të marrë një përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Praktika Penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e dëshmive materiale në mënyrë të qëllimshme për hetimin ose kryerjen e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese ose Praktikë të Fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi ose frikësimi i cilitdo personi për ta penguar atë, të zbulojë njohuritë e tij për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin ose ndjekjen e hetimit; ose ii) çdo veprim që ka për qëllim të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese ose Praktikë të fshehtë.

Person: çdo person fizik, ent ligjor, partneritet ose shoqëri e pa themeluar.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (si termat të tillë të përcaktuara këtu), e cila: i) është e paligjshme sipas ligjit gjerman ose ndonjë ligji tjetër në fuqi; dhe ii) e cila ka, ose potencialisht mund të ketë, një efekt ligjor material ose reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Marrësit dhe KfW-së ose zbatimit të saj.

Sanksionet: ligjet për sanksionet ekonomike, financiare ose tregtare, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga cilitdo organ sanksionues.

Organi sanksionues: cilitdo prej Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Republikës Federale të Gjermanisë.

Lista e sanksioneve: çdo listë me persona, grupe ose ente të caktuara specifikuara, të cilët i nënshtrohen Sanksioneve, siç është lëshuar nga çdo organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Marrësi

a) do vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së, sipas kërkesës, të gjitha informacionet që kanë lidhje me “njihni klientin tuaj” ose



informacione të ngjashme për Marrësin, ashtu siç mund ta kërkojë KfW-ja;

b) nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, t'i sigurojë menjëherë KfW-së sipas kërkesës, të gjitha informacionet dhe dokumentet e Marrësit dhe të palëve të tij (nën)kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të për Shërbimet e Ekspertëve, të cilat janë të nevojshme për KfW-në, të përmbushë detyrimet e saj në mënyrë që të parandalojë çdo Praktikë të Sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Marrësin, i cili është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, të informojë KfW-në, menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo vihet në dijeni ose dyshon për çfarëdo Praktike të Sanksionueshme, vepër e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit e cila lidhet me Shërbimet e Ekspertëve;

d) nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, t'i sigurojë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për Shërbimet e Ekspertëve dhe progresin e tyre të mëtejshëm, siç mund ta kërkojë KfW-ja për qëllimet të këtij aneksi; dhe

e) nëpërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit, t'i mundësojë KfW-së dhe agjentëve të saj në çfarëdo lloji kohe, të inspektojë të gjithë dokumentacionin e Marrësit dhe të palëve të tij (nën)kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të, siç është e përshtatshme për zbatimin e Shërbimeve të Ekspertëve për qëllime të këtij aneksi.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1 Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të Marrësit, Marrësi përfaqëson se asnjë nga Personat të cilët veprojnë në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve në emër të Marrësit nuk ka kryer ose nuk është i angazhuar në asnjë praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia të parashtruara në këtë nen kryhen për herë të parë nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje. Do konsiderohet të përsëritet mbi çdo tërheqje të kontributit financiar duke iu referuar rrethanave që dominojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Marrësi merr përsipër, sapo Marrësi ose KfW-ja vihen në dijeni ose dyshojnë për çdo praktikë të sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave ose financim të terrorizmit, për të bashkëpunuar plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, në përcaktimin nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në mënyrë të veçantë, Marrësi do të përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme ndaj çdo njoftimi nga KfW-ja dhe do të sigurojë mbështetje dokumentare për një përgjigje të tillë me kërkesën e KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi nuk do kryejë asnjë transaksion, as nuk do angazhohet në asnjë aktivitet tjetër në lidhje me Shërbimet e Ekspertëve të cilat do përbënin një shkelje të Sanksioneve.

ANEKSI 1B

ANGAZHIME TË PAJTUESHMËRISË SË AGJENCISË ZBATUESE TË PROJEKTT

1. PËRKUFIZIME

Praktika shtrënguese: dëmtimi ose cënimi, ose kërcënim i për të dëmtuar ose cënuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo person ose pasuri të personit me qëllim që të ndikojë në mënyrë të papërshtatshme veprimet e një personi.

Praktika e fshehtë: një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, e hartuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

Praktika korruptive: premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo pagese të paligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çdo natyre, për ose nga cilido person, me qëllim ndikimin e veprimeve të çdo personi ose shkaktimin e përmbajtjes së cilitdo personi nga çfarëdo veprimi.

Kategori të caktuara shkeljesh: kategoritë e mëposhtme të shkeljeve të përcaktuara sipas rekomandimeve të FATF dhe shënimet interpretuese përkatëse: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe mashtrimi/shantazhi; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e emigrantëve; shfrytëzimi



seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimin e paligjshëm të barnave narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimin e paligjshëm të armëve; trafikimin e paligjshëm të mallrave të vjedhura dhe të mallrave të tjera; korrupsioni dhe ryshfeti; mashtrimi; falsifikimi i monedhës; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi, mbajtja e paligjshme dhe marrja peng; grabitja ose vjedhja; kontrabanda (duke përfshirë lidhjen me doganat dhe akcizat dhe taksat); krimet tatimore (lidhur me taksat direkte dhe indirekte); zhvatja; falsifikimi; pirateria; tregtimi i paligjshëm në bursë dhe manipulimi i tregut.

Rekomandimet e FATF-së: rekomandime të tilla siç përcaktohen herë pas here nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF). FATF është organi ndërqeveritar, qëllimi i të cilit është zhvillimi dhe promovimi i politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Praktika mashtruese: çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë keqinterpretimin që me vetëdije ose nga pakujdesia mashtron ose përpiket të mashtrorë një person për të marrë një përfitim financiar ose për të shmangur një detyrim.

Origjina e paligjshme: origjina e fondeve të përfituara nëpërmjet

a) çdo shkeljeje të listuar në kategoritë e përcaktuara të shkeljeve;

b) çdo praktikë korruptive;

c) çdo praktikë mashtruese; ose

d) pastrim parash.

Praktika Penguese: i) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e dëshmive materiale në mënyrë të qëllimshme për hetimin ose kryerjen e deklaratave të rreme për hetuesit, në mënyrë që të pengojë materialisht një hetim zyrtar në pretendimet për një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese ose Praktikë të Fshehtë ose kërcërimi, ngacmimi ose frikësimi i cilitdo personi për ta penguar atë të zbulojë njohuritë e tij për çështjet që kanë të bëjnë me hetimin ose ndjekjen e hetimit; ose ii) çdo veprim që ka për qëllim të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionet e kërkuara kontraktuale në lidhje me një hetim zyrtar në pretendimet për një

Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrënguese ose Praktikë të fshehtë.

Person: çdo person fizik, ent ligjor, partneritet ose shoqëri e pa themeluar.

Praktikë e sanksionueshme: çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktikë mashtruese ose praktikë penguese (siç terma të tillë përcaktohen këtu), e cila: i) është e paligjshme sipas ligjit gjerman në fuqi ose ligji tjetër në fuqi; dhe ii) e cila ka, ose potencialisht mund të ketë, një efekt ligjor material ose reputacional në këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe KfW-së ose zbatimit të saj.

Sanksionet: ligjet për sanksionet ekonomike, financiare ose tregtare, rregulloret, embargot ose masat shtrënguese të administruara, të miratuara ose të zbatuara nga cildo organ sanksionues.

Organi sanksionues: cildo prej Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Republikës Federale të Gjermanisë.

Lista e sanksioneve: çdo listë me persona, grupe ose ente të caktuara specifikisht, të cilët i nënshtrohen sanksioneve, siç është lëshuar nga çdo organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA E INFORMACIONIT

Agjencia Zbatuese e Projektit

a) do vendosë menjëherë në dispozicion të KfW-së, sipas kërkesës, të gjitha informacionet që kanë lidhje me “njihni klientin tuaj” ose informacione të ngjashme për Agjencinë Zbatuese të Projektit, ashtu siç mund ta kërkojë KfW-ja;

b) t’i sigurojë menjëherë KfW-së sipas kërkesës, të gjitha informacionet dhe dokumentet e Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe të palëve të saj (nën)kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të, të cilat janë të nevojshme për KfW-në të përmbushë detyrimet e saj në mënyrë që të parandalojë çdo praktikë të sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit me Agjencinë Zbatuese të Projektit, i cili është i nevojshëm për këtë qëllim;

c) do informojë KfW-në, menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo të vihet në dijeni ose të dyshojë për ç’do praktike të sanksionueshme, vepër të pastrimit të parave dhe/ose financimi të



terrorizmit nga Agjencia Zbatuese e Projektit, cilido anëtar i organeve menaxhuese ose organeve të tjera drejtuese ose cilido prej aksionarëve të saj;

d) do i sigurojë KfW-së të gjitha informacionet dhe raportet për Shërbimet e Ekspertëve dhe progresin e tyre të mëtejshëm, ashtu siç mund ta kërkojë KfW-ja për qëllime të këtij aneksi;

e) do i mundësojë KfW-së dhe agentëve të saj në çdo kohë të inspektojnë të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me Shërbimet e Ekspertëve të Agjencisë Zbatuese të Projektit dhe të palëve të saj (nën)kontraktuese dhe të palëve të tjera që lidhen me të, si dhe të vizitojnë Shërbimet e Ekspertëve dhe të gjitha instalimet që lidhen me to për qëllimet e këtij aneksi;

f) do informojë KfW-në, menjëherë dhe me pëlqimin e saj, për çdo ngjarje që rezulton në cilindo prej sa vijon: Agjencia Zbatuese e Projektit, çfarëdo anëtar i organeve menaxhuese ose organe të tjera drejtuese ose cilido prej aksionarëve të saj, që është ose bëhet një shtetas i caktuar në mënyrë të posaçme, person i bllokuar ose ent që ruhet në çfarëdo liste sanksionesh.

3. PËRFAQËSIME DHE GARANCI

3.1 Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë Zbatuese të Projektit, Agjencia Zbatuese e Projektit përfaqëson dhe garanton se sa vijon është e vërtetë dhe korrekte:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia Zbatuese e Projektit vepron në emër të saj dhe për llogari të saj.

b) Sipas njohurive të saj më të mira dhe vetëm në lidhje me aksionarët e njohur për Agjencinë Zbatuese të Projektit, në vijim të rregullave që zbatohen për tregun e bursës, as kapitali i Agjencisë Zbatuese të Projektit, as fondet e investuara në Shërbimet e Ekspertëve nuk janë me origjinë të paligjshme.

c) Asnjë nga Agjencia Zbatuese të Projektit, filialet e saj, degët e saj apo çdo personi tjetër në emër të saj ose të tyre nuk ka kryer ose nuk angazhohet në asnjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

d) Agjencia Zbatuese e Projektit nuk ka lidhur: i) asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas të caktuar në mënyrë të posaçme, persona të bllokuar ose ent që ruhet në çdo listë

sanksionesh; ose ii) të angazhuar në çdo lloj aktiviteti tjetër që do përbënte një shkelje të sanksioneve.

3.2 Përfaqësimet dhe garancitë e parashtruara në këtë nen bëhen për herë të parë me anë të ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen se do të përsëriten me çdo tërheqje të Kontributit Financiar duke iu referuar rrethanave që dominojnë në atë datë.

4. SIPËRMARRJE POZITIVE

Agjencia Zbatuese e Projektit merr përsipër

a) të jetë në përputhje të plotë me standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me rekomandimet e FATF dhe të zbatojë, ruajë dhe nëse është e nevojshme, të përmirësojë standardet dhe udhëzimet e saj të brendshme (duke përfshirë pa kufizim në lidhje me klientin, verifikimin paraprak) të përshtatshëm për të shmangur çdo praktike të sanksionueshme, veprë të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia Zbatuese e Projektit ose KfW-ja vihen në dijeni ose dyshojnë për çdo Praktikë të Sanksionueshme, veprë të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit, për të bashkëpunuar plotësisht me KfW-në dhe agentët e saj, në përcaktimin nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në mënyrë të veçantë, Agjencia Zbatuese e Projektit do përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme ndaj çdo njoftimi nga KfW dhe të japë mbështetje dokumentuese për një përgjigje të tillë me kërkesën e KfW-së.

5. SIPËRMARRJE NEGATIVE

Agjencia Zbatuese e Projektit merr përsipër:

a) të sigurojë se kapitali i saj dhe fondet e tjera të cilat ajo investon nuk do jenë me origjinë të paligjshme;

b) të sigurojë se biznesi i saj nuk do çojë në asnjë praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe

c) të mos lidhë apo vazhdojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas të caktuar në mënyrë të posaçme, persona të bllokuar ose ent që ruhet në çdo listë sanksionesh dhe nuk do angazhohet në asnjë lloj aktiviteti tjetër që do përbënte një shkelje të sanksioneve.



VENDIM
Nr. 492, datë 10.7.2019

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE TË
KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS
TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E
BOTIMEVE PËR DIASPORËN, PËR
VITIN SHKOLLOR 2019–2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 10, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të pikës 19, të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra e Botimeve për Diasporën, me qëllim mundësimin e ruajtjes, të zhvillimit dhe mësimin të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, boton dhe siguron falas, për vitin shkollor 2019–2020, tekstet shkollore dhe ato plotësuese, sipas listës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kategoritë që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën janë nxënësit dhe mësuesit sipas përcaktimeve në vendimin nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.

3. Tekstet shkollore dhe ato plotësuese, të botuara dhe të siguruar nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura me logon e këtij institucioni dhe me pullën hologramë të certifikimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Qendra e Botimeve për Diasporën siguron pullën me hologramë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë kundrejt pagesës.

4. Çmimet e teksteve shkollore dhe ato plotësuese për mësimdhënien në diasporën shqiptare vendosen në kopertinat e tyre përkatëse, në përputhje me listën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën.

6. Ngarkohet Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**LISTA E TEKSTEVE SHKOLLORE PËR DIASPORËN,
PËR VITIN SHKOLLOR 2019–2020**

Nr.	Titulli	Tirazhi	Çmimi për copë / lekë
1	Abetare (<i>Shkronjë pas Shkronjë</i>)	3 215 copë	507 lekë
2	Fletore pune Abetareje	2 775 copë	243 lekë
3	Gjuhë shqipe 2	1 510 copë	453 lekë
4	Fletore pune 2	330 copë	250 lekë
5	Gjuhë shqipe 3	945 copë	394 lekë
6	Fletore pune 3	330 copë	300 lekë
7	Gjuhë shqipe 4	310 copë	460 lekë
8	Fletore pune 4	200 copë	300 lekë



9	Gjuhë shqipe 5	185 copë	530 lekë
10	Fletore pune 5	150 copë	250 lekë
11	Gjuhë shqipe 6	85 copë	539 lekë
12	Fletore pune 6	50 copë	250 lekë
13	Histori e Shqipërisë 9	220 copë	297 lekë
14	Gjeografi e Shqipërisë 9	220 copë	284 lekë
15	Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 1 / Sete shkollore për fillestarë	120 copë	346 lekë
16	Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 2 / Sete shkollore për më të rritur	150 copë	346 lekë
17	Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 3/ Sete shkollore për më të rritur	150 copë	346 lekë
18	Matematika 1	24 copë	530 lekë
19	Matematika 2	24 copë	291 lekë
	TOTALI	10 993 copë	4 231 499 lekë

Shënim. Siç mund të vërehet edhe në buxhetin e parashikuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën, të miratuar nga MFE-ja, zëri për blerje të teksteve shkollore/libra prej **6 000 000 lekësh** është i mjaftueshëm për të përballuar shpenzimet e mësipërme, me një total prej **4 231 499 lekësh**.

UDHËZIM

Nr. 4, datë 28.6.2019

PËR DOKUMENTET PËR QARKULLIM DHE REGJISTRIM TË MJETEVE RRUGORE

Në mbështetje të pikës 4, neni 102 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 80, 92–102 dhe 220–224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neneve 237–252, 368 dhe 370, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Rregullorja e Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë,

UDHËZON:

Neni 1

Identifikimi i aplikantit

1. Aplikanti, që do të kuptohet individ, subjekti, ose përfaqësuesi ligjor i tyre, për të kërkuar shërbimet që përcakton ky udhëzim, duhet të identifikohet:

a) për individët, kartë identiteti, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikantit;

b) për subjektet, Ekstrakt i QKB-së në origjinal ose i printuar drejtpërdrejt nga faqja e internetit të QKB-së në sportel, i cili legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, si dhe autorizim për personin që do të kryejë veprimet, nëse nuk është përfaqësuesi ligjor i subjektit;



c) për subjektet që me ligj nuk regjistrohen në QKB, p.sh. institucionet shtetërore, diplomatike, organizatat joqeveritare etj., duhet vetëm fotokopje e NIPT-it, e njehsuar me origjinalin, me vulën zyrtare të institucionit përkatës, shoqëruar me autorizimin për personin që do të kryejë veprimet;

d) për shtetasit e huaj rezidentë në Republikën e Shqipërisë, leje qëndrimi e lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Brendshme, e cila pasi fotokopjohet dhe legalizohet nga nëpunësi i pranimit sipas rregullave në fuqi, i kthehet përsëri aplikantit;

e) për personelin e trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë, fotokopja e kartës identifikuese diplomatike/shërbimit me vulën e ambasadës.

KREU I

AUTOMJETET, MOTOMJETET, RIMORKIOT, MAKINAT BUJQËSORE DHE MAKINAT TEKNOLOGJIKE

A. REGJISTRIMI I PARË

Neni 2

Shërbimi i regjistrimit të parë

1. Automjetet, motomjetet, rimorkiot, makinat bujqësore dhe ato teknologjike për të qarkulluar duhet të jenë regjistruar pranë sporteleve të drejtorive rajonale të shërbimeve të transportit rrugor, ose zyrave të shërbimit në varësi të DPSHTRR-së dhe të jenë të pajisura me dokumentacionin e nevojshëm dhe targë.

2. Me regjistrim të mjetit kuptohet kërkesa nga subjekti fizik ose juridik, identifikimi i treguesve të mjetit, pranimi i dokumentacionit, leximi automatik dhe/ose manual, evidentimi i të dhënave, si dhe lëshimi i lejes së qarkullimit, targës si dhe certifikatës së pronësisë së mjetit.

3. Regjistrimi i të dhënave të mjeteve dhe pronarëve ose përdoruesve legjitimë bëhet në regjistrin elektronik kombëtar, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 7 të këtij udhëzimi.

Neni 3

Identifikimi i treguesve të mjetit

1. Aplikimi për regjistrimin fillon me identifikimin e treguesve të mjetit.

2. Identifikimi i treguesve të mjetit përmbledh:

a) këqyrjen fizike të mjetit me qëllim identifikimin e tij, bazë e të cilit është numri i identifikimit i stampuar në shasi;

b) leximin automatik dhe/ose manual për përcaktimin e saktë të karakteristikave teknike të mjetit duke i ballafaquar edhe me dokumentacionin teknik shoqërues;

c) hedhjen dhe pasqyrimin e të dhënave të lartpërmendura në Regjistrin Elektronik, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

d) printimin e të dhënave për identifikim të mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

e) fotografi digjitale për mjetin.

3. Në rastet kur konstatohen parregullsi, dëmtime, mungesë e numrit të identifikimit, apo mungesë e tabelës identifikuese, bëhet fotografimi i numrit të identifikimit të stampuar në shasi.

4. Për rastet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, në Regjistër dhe në formularin për identifikim të mjetit, vendoset shënimi përkatës sipas rastit të konstatuar.

5. Identifikimi i treguesve të mjetit kryhet nga një specialist.

6. Identifikimi i treguesve të mjetit kryhet nga DPSHTRR-ja, për regjistrimin për herë të parë, për ndryshimin e pronësisë, ristampimin e numrit të identifikimit dhe kur konstatohet ndryshim i treguesve konstruktiv apo funksional të mjetit.

Neni 4

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim

1. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e reja, të blera jashtë shtetit:

a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm;

b) certifikatë përputhje ose dokument me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit të lëshuar nga prodhuesi, në origjinal;



c) dokument që konfirmon kryerjen e procedurave doganore;

d) kontratën e sigurimit të mjetit sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e reja, të blera në vend:

a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm;

b) certifikatë përputhje ose dokument, me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit, të lëshuar nga prodhuesi, në origjinal;

c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni;

d) kontratën e sigurimit të mjetit sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF;

e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të blera jashtë shtetit ose në vend:

a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm;

b) dokumentet shoqërues me treguesit teknikë dhe të pronësisë së mjetit, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit nga vjen mjeti si leje qarkullimi dhe/ose certifikatë pronësie, ose çregjistrim për eksport, në origjinal;

c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni;

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF;

e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS, për mjetet e përdorura të blera në vend.

4. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, por të paregjistruara në Shqipëri:

a) faturën tatimore shitje, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal), ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin);

b) fotokopjen e njëzuar me origjinalin të dokumentit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruesit të mjetit;

c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni;

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

5. Dokumentet që janë në gjuhë të huaj, duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

Neni 5

Makinat bujqësore që i nënshtrohen regjistrimit

Makinat bujqësore, që i nënshtrohen regjistrimit dhe që pajisen me leje qarkullimi dhe targë janë:

a) traktorët bujqësorë;

b) makinat bujqësore teknologjike me dy ose më shumë akse;

c) rimorkiot bujqësore me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 1,5 tonë.

Neni 6

Pranimi i dokumentacionit

1. Aplikanti sipas nenit 1, aplikon pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, duke nënshkruar formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

2. Dorëzon sipas llojit të shërbimit dokumentacionin përkatës të përmendur në nenet 3 dhe 4, të këtij udhëzimi.

3. Zyra e regjistrimit, pranon dokumentacionin kur ai është i plotë si në formë dhe në përmbajtje dhe kur të dhënat e identifikimit të mjetit përputhen me ato të shënuara në dokumentacionin shoqërues. Në të kundërt, dokumentacioni i kthehet personit, së bashku me “Procesverbalin e refuzimit të shërbimit” ku përcaktohen saktë arsyet e mospranimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.



Neni 7

Evidentimi i të dhënave, lëshimi i lejes së qarkullimit, certifikatës së pronësisë dhe targës

1. Të dhënat e mjetit dhe të pronarit evidentohen në:

- a) sistemin informatik e-DPSHTRR;
- b) Regjistrin Elektronik të mjeteve, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
- c) kartelën elektronike të mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;
- d) lejen e qarkullimit të mjetit, model DRM - 04, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja dhe miratuar nga ministri përgjegjës për transportin;
- e) certifikatën e pronësisë së mjetit, model DRM - 05, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja dhe miratuar nga ministri përgjegjës për transportin.

2. Me dokumentacionin e dorëzuar krijohet dosja e mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

3. Kartela elektronike, pas çdo veprimi me mjetin, printohet dhe bashkëngjitet me dokumentet e tjera në dosje.

4. Mbas verifikimit dhe evidentimit të dhënave, zyra e regjistrimit i lëshon personit të interesuar lejen e qarkullimit, certifikatën e pronësisë dhe targën/at e mjetit.

Neni 8

Lëshimi i targës përsëritëse

1. Në rastet kur kërkohet targë përsëritëse, për karrel ose rimorkio me një aks deri në 750 kg, që i bashkëlidhet një automjeti, aplikanti bashkë me lejen e qarkullimit të automjetit që do t'i bashkëlidhet dorëzon edhe:

- a) dokumentacion të njëjtë me ato në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 4, edhe kur karreli vjen nga importi.
- b) dokumentacion të njëjtë me atë të përcaktuar në nenin 4, pika 4, për karrelin e përdorur, të shitur me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) shënon të dhënat shtesë të karrelit dhe lëshon lejen e qarkullimit të automjetit që do të bashkëlidhet me këto të dhëna;

c) lëshon brenda kohës së aplikimit targën përsëritëse, në zbatim të VKM nr. 724, datë 1.9.2010, të njëjtë me atë të automjetit që do të bashkëlidhet;

d) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli, i cili futet në dosjen e automjetit që do të bashkëlidhet.

B. NDRYSHIMET NË REGJISTËR

Neni 9

Përditësimi i të dhënave të dokumentacionit për një mjet të regjistruar

Përditësimi i të dhënave të dokumentacionit për një mjet të regjistruar bëhet, kur:

- a) ndryshon vendbanimi ose gjeneralitetet e pronarit;
- b) ndryshon pronësia;
- c) humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet leja e qarkullimit;
- d) humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet targa;
- e) humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet certifikata e pronësisë;
- f) ndryshim i karakteristikave konstruktive apo funksionale;
- g) shënohet numër i ri identifikimi.

Neni 10

Ndryshimi i vendbanimit ose gjeneraliteteve të pronarit të mjetit

1. Kur pronari i mjetit ndryshon vendbanimin, ai dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) certifikatën e pronësisë së mjetit;

d) kur pronari ndryshon bashkinë e vendbanimit, dorëzon targat vetëm nëse ato janë të sistemit të vjetër. Nuk dorëzohen targat, nëse



janë të sistemit të ri, në zbatim të VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010.

2. Kur pronari ndryshon vendbanimin brenda bashkisë, zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik e-DPSHTRR, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse duke vendosur adresën e saktë të vendbanimit sipas regjistrit të gjendjes civile;

b) me dokumentet e dorëzuara krijohet fashikulli sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, që futet në dosjen përkatëse të mjetit;

c) lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

d) lëshon certifikatën e pronësisë së mjetit.

3. Kur pronari ndryshon vendbanimin brenda bashkive, që ka nën juridiksion Drejtoria Rajonale, zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik e-DPSHTRR, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse duke vendosur adresën e saktë të vendbanimit sipas regjistrit të gjendjes civile;

b) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja magazinon targat, nëse ato janë sipas sistemit të vjetër;

c) me dokumentet e dorëzuara krijohet fashikulli sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, që futet në dosjen përkatëse të mjetit;

d) lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

e) i dorëzon aplikantit targat e reja të mjetit, në zbatim të VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër;

f) lëshon certifikatën e pronësisë së mjetit.

4. Kur pronari ndryshon vendbanimin jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale, zyra e regjistrimit e Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksion vendbanimin e ri:

a) i bën kërkesë Drejtorisë Rajonale, ku mjeti është i regjistruar për transferimin e dosjes së mjetit, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;

b) bën ndryshimet në sistemin informatik e-DPSHTRR, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse duke vendosur adresën e saktë të vendbanimit sipas regjistrit të gjendjes civile;

c) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja, magazinon targat e mjetit, nëse ato janë sipas sistemit të vjetër;

d) lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

e) i dorëzon aplikantit targat e reja të mjetit, në zbatim të VKM nr. 724, datë 1.9.2010, në rastet kur ky i fundit ka pasur targa të sistemit të vjetër;

f) lëshon certifikatën e pronësisë së mjetit;

g) merr nga Drejtoria Rajonale, ku mjeti ka qenë i regjistruar, dosjen dhe vërtetimin e çregjistrimit të mjetit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

h) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, që futet në dosjen përkatëse të mjetit.

5. Kur pronari i mjetit ndryshon gjeneralitetet, veprohet njëjloj si në pikën 1 dhe 2, të këtij neni.

Neni 11

Ndryshimi i pronësisë

1. Kur ndryshon pronësia mbi mjetin, aplikanti, dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) dokumentin e fitimit të pronësisë të vlefshëm, në origjinal;

c) lejen e qarkullimit të mjetit;

d) certifikatën e pronësisë së mjetit;

e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS.

f) kur pronari ndryshon bashkinë e vendbanimit dorëzon dhe targat, vetëm nëse ato janë të sistemit të vjetër.

2. Për mjetet e regjistruara në Arkivin Kombëtar të Mjeteve, që shiten me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, aplikanti dorëzon edhe këto dokumente:

a) Faturën tatimore të shitjes, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal), ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin);

b) fotokopjen e njëzuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në



momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e targave.

3. Kur aplikanti ka vendbanimin në të njëjtën bashki me pronarin e vjetër, zyra e regjistrimit vepron njëllor si në pikën 2 të nenit 10.

4. Kur aplikanti ka vendbanimin në një bashki tjetër, brenda juridiksionit të Drejtorisë Rajonale ku mjeti është i regjistruar, zyra e regjistrimit vepron njëllor si në pikën 3, të nenit 10.

5. Kur aplikanti ka vendbanimin në një bashki jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale ku mjeti është i regjistruar, zyra e regjistrimit e Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksion vendbanimin e ri, vepron njëllor si në pikën 4 të nenit 10.

Neni 12

Humbja, vjedhja, shkatërrimi ose dëmtimi i lejes së qarkullimit

1. Në rastet e humbjes ose vjedhjes të lejes së qarkullimit, pasi vërtetimi i denoncimit për humbjen e lejes së qarkullimit i lëshuar nga organet e policisë është depozituar në sekretari, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

2. Zyra e regjistrimit:

a) konfirmon në sekretari vërtetimin e denoncimit të lëshuar nga organet e policisë

b) plotëson Regjistrin e lejeve të përkohshme të qarkullimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

c) plotëson dhe lëshon lejen e përkohshme të qarkullimit, model DRM - 08, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja;

d) me dokumentet e dorëzuara, krijohet fashikulli përkatës, i cili mbahet në zyrën e regjistrimit.

3. Pasi të kenë kaluar 30 ditë nga data e vërtetimit të denoncimit, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, në vazhdim të pikës 1, germa “a”, të këtij neni;

b) lejen e përkohshme të qarkullimit të mjetit.

4. Zyra e regjistrimit, në rastet kur leja e qarkullimit nuk është gjetur ose dorëzuar brenda afatit prej 30 ditësh:

a) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit;

b) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

c) me dokumentet e dorëzuara, plotësohet fashikulli i krijuar sipas pikës 2, germa “d”, të këtij neni, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

5. Në rastet e dëmtimit të lejes së qarkullimit (leja e qarkullimit konsiderohet e dëmtuar, kur ajo është bërë e papërdorshme, por e identifikueshme) aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të dëmtuar.

6. Zyra e regjistrimit:

a) lëshon lejen e qarkullimit të re;

b) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

7. Në rastin e shkatërrimit të lejes së qarkullimit, do të veprohet njëllor si në rastet e humbjes ose vjedhjes.

Neni 13

Humbja, vjedhja, shkatërrimi ose dëmtimi i targës

1. Në rastet e humbjes ose vjedhjes së targës, pasi vërtetimi i denoncimit të humbjes së targës i lëshuar nga organet e policisë është depozituar në sekretari, atëherë aplikanti, 15 ditë nga data e lëshimit të vërtetimit të denoncimit, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) certifikatën e pronësisë së mjetit.

d) targën, kur është denoncuar humbja e njërës prej tyre.

2. Zyra e regjistrimit, 15 ditë nga data e lëshimit të vërtetimit të denoncimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;



b) magazinon targën, kur është denoncuar humbja e njërës prej tyre;

c) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

d) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit;

e) lëshon targat e reja të mjetit;

f) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

3. Në rastet e dëmtimit të targës kur numri i regjistrimit lexohet, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) vetëm targën e dëmtuar të mjetit, kur ajo është sipas VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010; ose

c) vepron sipas pikës 1 të këtij neni, germat “b”, “c” dhe “d”, kur kërkon ndërrimin e targave apo kur mjeti ka pasur targa të sistemit të vjetër.

4. Zyra e regjistrimit:

a) lëshon targën me të njëjtin numër kur ajo është sipas VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010; ose

b) vepron si në pikën 2 të këtij neni, kur është kërkuar ndërrimi i targave apo kur mjeti ka pasur targa të sistemit të vjetër.

5. Në rastin e dëmtimit apo shkatërrimit të targës dhe për pasojë numri i regjistrimit nuk lexohet, do të veprohet njëloj si në rastet e humbjes ose vjedhjes.

Neni 14

Humbet, vidhet, shkatërrohet ose dëmtohet certifikata e pronësisë së mjetit

1. Në rastet e humbjes, vjedhjes, shkatërrimit ose dëmtimit të certifikatës së pronësisë së mjetit aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) deklarimi për humbjen e certifikatës së pronësisë përpara nëpunësit të pranimi me përgjegjësi administrative të deklaruesit, e shprehur në modelin e shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

Neni 15

Ndryshimi i karakteristikave konstruktive apo funksionale të mjetit

1. Në rastet e ndryshimit të karakteristikave konstruktive apo funksionale të mjetit, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) certifikatën e miratimit përfundimtar të ndryshimit lëshuar nga subjekti i licencuar nga MIE;

c) lejen e qarkullimit të mjetit;

d) certifikatën e pronësisë së mjetit.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) plotëson dhe lëshon lejen e re të qarkullimit të mjetit;

c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit, vetëm nëse ndryshojnë të dhënat që ajo përmban;

d) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit.

Neni 16

Shënimi i numrit të ri të identifikimit të mjetit

1. Shënimi i numrit të ri të identifikimit të mjetit, bëhet vetëm nga zyra përgjegjëse në DPSHTRR, e cila lëshon aktin përkatës.

2. Aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) certifikatën e pronësisë së mjetit.

3. Zyra e regjistrimit vepron njëloj si në pikën 2, të nenit 15.

4. Ngarkohet DPSHTRR të hartojë rregulla më të detajuara për procedurat e ri stampimit.



C. HEQJA NGA QARKULLIMI I MJETEVE

Neni 17

Heqja e përkohshme nga qarkullimi i mjeteve

1. Në rastet kur kërkohet çregjistrim i përkohshëm i mjetit, sipas nenit 9, pika 1 e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, aplikanti pasi ka paguar detyrimet përkatëse për taksat e mjetit, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) targat e mjetit.

2. Zyra e regjistrimit:

a) bën shënimet në sistemin informatik për heqjen e përkohshme nga qarkullimi;

b) me dokumentet e dorëzuara krijohet fashikull, i cili së bashku me targat e mjetit ruhet në arkiv, në dosarë të veçantë;

c) lëshon vërtetimin e çregjistrimit të përkohshëm, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja.

3. Në rastet kur kërkohet reregjistrimi i mjetit, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) dokumentin e çregjistrimit të përkohshëm.

4. Zyra e regjistrimit:

a) bën shënimet në sistemin informatik për përfundimin e heqjes së përkohshme nga qarkullimi të mjetit;

b) dokumentet e dorëzuara, i sistemon në fashikullin e krijuar për heqjen e përkohshme të mjetit nga qarkullimi, të cilin e sistemon në dosjen e mjetit;

c) konfirmon rikthimin në qarkullim me vërtetimin përkatës;

d) i kthen personit lejen e qarkullimit dhe targat e mjetit.

Neni 18

Heqja e përhershme e mjeteve nga qarkullimi

Heqja e përhershme nga qarkullimi bëhet kur mjeti:

- eksportohet;

- del jashtë përdorimit.

1. Në rastet kur mjeti eksportohet, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale ku mjeti është i regjistruar, për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) lejen e qarkullimit të mjetit;

c) certifikatën e pronësisë së mjetit;

d) targat e mjetit.

e) nëse personi është shtetas i huaj, jo rezident në Shqipëri, si dokument identifikimi duhet fotokopje e noterizuar e pasaportës, ose e kartës së identitetit;

f) dokumentin e fitimit të pronësisë, kur ka ndryshim pronësie;

g) kur mjeti i eksportuar është regjistruar në një shtet tjetër, dokumentet sipas germave “b”, “c” dhe “d”, nëse mungojnë do të zëvendësohen me vërtetimin në origjinal me konfirmimin përkatës të lëshuar nga autoritetet e shtetit që ka bërë regjistrimin, me vulë apostile.

2. Zyra e regjistrimit, sipas kërkesës nga aplikanti:

a) bën shënimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse.

b) plotëson dhe lëshon lejet e qarkullimit të përkohshme të mjetit kombëtare dhe lejen e qarkullimit ndërkombëtare.

c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të pronësisë së mjetit, me shënimin “Për eksport”.

d) lëshon targat e përkohshme të mjetit, në zbatim të VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010.

e) kur ndryshon pronësia, dokumentet lëshohen në emër të pronarit të ri të mjetit.

f) lëshon vërtetimin zyrtar të heqjes së përhershme të mjetit nga qarkullimi për eksport, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

g) magazinon targat e mjetit.

3. Kur mjeti del jashtë përdorimit, aplikanti dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe



formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

- b) lejen e qarkullimit të mjetit.
- c) certifikatën e pronësisë së mjetit.
- d) targat e mjetit.

e) certifikatën e shkatërrimit lëshuar nga subjekti i licencuar për depozitimin e mjeteve në fund të jetës ose dokument të barasvlershëm nëse shkatërrimi ka ndodhur jashtë shtetit.

4. Zyra e regjistrimit:

- a) bën shënimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;
- b) me dokumentet e dorëzuara, krijohet një fashikull, i cili sistemohet në dosjen e mjetit;
- c) magazinon targat e mjetit;
- d) lëshon vërtetimin zyrtar të heqjes së përhershme të mjetit nga qarkullimi për jashtë përdorimi, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

KREU II CIKLOMOTORËT

A. REGJISTRIMI I PARË

Neni 19

Shenja e identifikimit të ciklomotorit

1. Për t'u pajisur me shenjën e identifikimit të ciklomotorit, aplikanti, që plotëson kushtet sipas nenit 241 të Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

2. Zyra e Regjistrimit:

- a) plotëson Regjistrin Elektronik të shenjave identifikuese të ciklomotorit;
- b) hedh të dhënat në sistemin informatik;
- c) plotëson dhe lëshon menjëherë dëshminë e shenjës identifikuese të ciklomotorit, modelDRM - 10, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja;
- d) lëshon menjëherë shenjën e identifikimit të ciklomotorit;
- e) me dokumentacionin e dorëzuar, krijohet dosja e mjetit.

Neni 20

Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim, certifikata e përshtatshmërisë teknike

1. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e rinj, të blerë jashtë shtetit:

- a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm;
- b) certifikatë përputhje ose teknike, ose dokument me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit, të lëshuar nga prodhuesi, në original;
- c) dokument që konfirmon kryerjen e procedurave doganore;
- d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR - AMF.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e rinj, të blerë në vend:

- a) dokumenti i fitimit të pronësisë, i vlefshëm.
- b) certifikatë përputhje ose teknike ose, dokument me të gjithë treguesit teknik të domosdoshëm për identifikimin e mjetit, të lëshuar nga prodhuesi, në original.
- c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni.
- d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR- AMF.

e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS.

3. Dokumentacioni i nevojshëm për të marrë certifikatën e përshtatshmërisë teknike për ciklomotorët e përdorur, të blerë jashtë shtetit ose në vend:

- a) dokumenti i fitimit të pronësisë, si në pikën 1, germa “a”, të këtij neni për ciklomotorët e blerë jashtë shtetit. Dokumenti i fitimit të pronësisë, si në pikën 2, germa “a” të këtij neni, për ciklomotorët e blerë në vend;
- b) dokumentet shoqëruese me treguesit teknik dhe të pronësisë së ciklomotorit, të lëshuar nga organet zyrtare të shtetit nga vjen ciklomotori, si leje qarkullimi dhe/ose certifikatë pronësie, ose çregjistrim për eksport, në original;
- c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni;



d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF;

e) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS, për ciklomotorët e përdorur të blerë në vend.

4. Dokumentacioni i nevojshëm për të regjistruar mjetet e përdorura, të shitura me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, por të pa regjistruara në Shqipëri.

a) faturë tatimore shitje, të lëshuar nga institucionet e mësipërme (në origjinal), ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin);

b) fotokopjen e njëzuar me origjinalin të dokumentit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruesit të mjetit;

c) konfirmimi i procedurave doganore, si në pikën 1, germa “c”, të këtij neni”;

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

5. Të gjitha dokumentet e lartpërmendur, që janë në gjuhë të huaj, duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

6. Zyra e regjistrimit, pasi verifikon dhe mban dokumentet, mbi bazën e tyre:

a) hedh të dhënat në sistemin informatik, plotëson Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) plotëson dhe lëshon menjëherë certifikatën e përshtatshmërisë teknike, model DRM - 12, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijohet dosja e mjetit.

B. NDRYSHIMET NË REGJISTËR

Neni 21

Ndryshimi i vendbanimit të personit të pajisur me shenjë e identifikimit

1. Kur personi i pajisur me Shenjë identifikimi ndryshon vendbanimin, dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) dëshminë e shenjes së identifikimit;

c) kur pronari ndryshon njësinë administrative të vendbanimit, dorëzon shenjën e identifikimit vetëm nëse ajo është sipas sistemit të vjetër.

2. Kur personi i pajisur me shenjën e identifikimit, ndryshon vendbanimin brenda njësisë administrative, Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet dosjen përkatëse të mjetit;

c) plotëson dhe lëshon dëshminë e re të shenjes së identifikimit;

3. Kur personi i pajisur me shenjën e identifikimit, ndryshon vendbanimin brenda njësisë administrative që ka nën juridiksion Drejtoria Rajonale, Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja magazinon shenjën e identifikimit, nëse ajo është sipas sistemit të vjetër;

c) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen përkatëse të mjetit;

d) plotëson dhe lëshon dëshminë e re të shenjes së identifikimit;

e) i dorëzon aplikantit shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit, në zbatim të VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010, në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë identifikimi të sistemit të vjetër.

4. Kur personi i pajisur me Shenjën e identifikimit të ciklomotorit, ndryshon vendbanimin jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale, Zyra e regjistrimit:



a) i bën kërkesë Drejtorisë Rajonale, ku personi ka qenë i regjistruar më parë, për dërgimin e dosjes;

b) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

c) plotëson dhe lëshon dëshminë e re të shenjës së identifikimit;

d) sipas procedurave të miratuara nga DPSHTRR-ja magazinon shenjën e identifikimit, nëse ajo është sipas sistemit të vjetër;

e) i dorëzon aplikantit shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit, në zbatim të VKM-së nr. 724, datë 1.9.2010, në rastet kur ky i fundit ka pasur shenjë identifikimi të sistemit të vjetër;

f) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen e ardhur nga Drejtoria Rajonale ku personi ka qenë i regjistruar më parë.

Neni 22

Ndryshimi i vendbanimit të pronarit të ciklomotorit

1. Kur pronari i ciklomotorit ndryshon vendbanimin, dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) certifikatën e përshtatshmërisë teknike.

2. Kur pronari i ciklomotorit, ndryshon vendbanimin brenda bashkisë, Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen përkatëse të mjetit;

c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të përshtatshmërisë teknike.

3. Kur pronari i ciklomotorit, ndryshon vendbanimin brenda bashkive që ka nën juridiksion Drejtoria Rajonale, Zyra e regjistrimit vepron njëjloj si në pikën 2 të këtij neni.

4. Kur pronari i ciklomotorit, ndryshon vendbanimin jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale, Zyra e regjistrimit, pasi i bën kërkesë Drejtorisë Rajonale, ku personi ka qenë i regjistruar më parë për transferimin e dosje dhe

konfirmon mbërritjen e saj, vepron njëjloj si në pikën 2 të këtij neni.

Neni 23

Ndryshimi i pronësisë së ciklomotorit

1. Kur ndryshon pronësia mbi ciklomotorin, pronari i ri dorëzon në zyrën e regjistrimit të Drejtorisë Rajonale që ka nën juridiksionin e saj vendbanimin e ri:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) aktin e fitimit të pronësisë së ciklomotorit, të vlefshëm;

c) certifikatën e përshtatshmërisë teknike;

d) konfirmimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-RBS.

2. Për mjetet e regjistruara në Arkivin Kombëtar të Mjeteve, që shiten me ankand nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) dhe nga Rezervat Materiale Shtetërore, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1, aplikanti dorëzon edhe këto dokumente;

a) faturën e shitjes me TVSH, të lëshuar nga institucionet e mësipërme, (në origjinal), ose urdhrin e ministrit përgjegjës për transferimin kapital të mjetit në favor të një institucioni tjetër shtetëror (fotokopje e njëzuar me origjinalin);

b) fotokopjen e njëzuar me origjinalin të procesverbalit mbi gjendjen fizike të mjetit në momentin e shitjes, në të cilin përveç të tjerave të evidentohet numri identifikimit të mjetit dhe sipas rastit mungesa e dokumenteve teknike shoqëruese të mjetit dhe mungesa e shenjës identifikuese;

c) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

3. Kur pronari i ri ka vendbanimin në të njëjtën bashki me pronarin e vjetër, Zyra e regjistrimit:

a) bën ndryshimet në sistemin informatik, Regjistrin Elektronik dhe kartelën përkatëse;

b) me dokumentet e dorëzuara, krijon fashikull, i cili futet në dosjen përkatëse të mjetit;



c) plotëson dhe lëshon certifikatën e re të përshtatshmërisë teknike.

4. Kur pronari i ri ka vendbanimin në një bashki tjetër, brenda juridiksionit të Drejtorisë Rajonale ku ciklomotori është i regjistruar, Zyra e regjistrimit vepron njëloj si në pikën 3 të këtij neni.

5. Kur pronari i ri ka vendbanimin në një bashki jashtë juridiksionit të Drejtorisë Rajonale ku ciklomotori është i regjistruar, Zyra e regjistrimit pasi i bën kërkesë Drejtorisë Rajonale, ku personi ka qenë i regjistruar më parë për transferimin e dosjes dhe konfirmon mbërritjen e saj në arkiv, vepron njëloj si në pikën 3 të këtij neni.

Neni 24

Humbja, vjedhja ose shkatërrimi i shenjës së identifikimit, dëshmisë së shenjës së identifikimit, certifikatës së përshtatshmërisë teknike

1. Në rast humbje, vjedhje ose shkatërrimi të shenjës së identifikimit, dëshmisë së shenjës së identifikimit, certifikatës së përshtatshmërisë teknike:

a) kur personi, mbajtës i shenjës së identifikimit, paraqitet vetëm për të bërë deklarin, zyra e regjistrimit bën shënimet përkatëse në Regjistrin e shenjave të identifikimit;

b) kur aplikanti, kërkon pajisjen me shenjën e re të identifikimit, dëshminë përkatëse apo certifikatën e përshtatshmërisë teknike, dorëzon vetëm aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja. Zyra e regjistrimit, lëshon shenjën e re të identifikimit të ciklomotorit dhe dëshminë e shenjës e re të identifikimit.

KREU III

MJETET RRUGORE TË VEÇANTA, HISTORIKE DHE JASHTË NORME

Neni 25

Regjistrimi i mjeteve rrugore të veçanta

Procedurat për regjistrimin e mjeteve rrugore të veçanta, kryhen sipas neneve përkatëse të këtij udhëzimi, në varësi të kategorisë, funksionit që

kryen dhe pajisjeve apo sistemeve specifike që ka mjeti.

Neni 26

Regjistrimi i mjeteve rrugore historike

Për procedurat e regjistrimit të mjeteve historike në regjistrin përkatës, ngarkohet DPSHTRR-ja të miratojë aktet të tjera në zbatim të këtij udhëzimi, në varësi të kategorisë së mjetit. Zyra e regjistrimit lëshon certifikatë njohje si mjet historik apo me interes koleksionimi, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja.

Neni 27

Regjistrimi i mjeteve rrugore jashtë norme

Procedurat për regjistrimin e mjeteve jashtë norme, kryhen sipas neneve përkatëse të këtij udhëzimi, në varësi të kategorisë së mjetit. Regjistrimi bëhet vetëm në emër të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e transportit me mjete jashtë norme, sipas objektit të aktivitetit të deklaruar në QKB.

KREU IV

TARGA PROVË, E PËRKOHSHME DHE LEJA NDËRKOMBËTARE E QARKULLIMIT

Neni 28

Lëshimi i targës së provës

1. Aplikanti si përfaqësues i subjektit juridik që plotëson kushtet sipas legjislacionit përkatës, për t'u pajisur me targë provë, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) vërtetim të lëshuar nga administratori që konfirmon të dhënat e personit mbajtës të autorizimit për qarkullimin provë;

c) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

2. Zyra e regjistrimit:

a) plotëson Regjistrin për targën e provës, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;

b) hedh të dhënat në sistemin informatik;



c) lëshon autorizimin për qarkullimin e provës me afat vlefshmërie 1-vjeçar, Model DRM- 34, sipas formatit të miratuar nga DPSHTRR-ja;

d) lëshon Librin për lëvizje me targë prove, i cili plotësohet paraprakisht kur del për qarkullimin e provës, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

e) lëshon targën e provës;

f) me dokumentet e dorëzuara, krijon dosjen.

3. Aplikanti, që plotëson kushtet sipas pikës 1 të këtij neni, për rinovimin e autorizimit për qarkullim provë, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) vërtetim të lëshuar nga administratori që konfirmon të dhënat e personit mbajtës të autorizimit;

c) autorizimin për qarkullimin provë të skaduar;

d) librin e lëvizjes me targë prove.

4. Zyra e regjistrimit pasi verifikon dokumentacionin sipas pikës 1 të këtij neni:

a) bën shënimet përkatëse në regjistrin e targave provë;

b) lëshon autorizimin për qarkullimin e provës me afat 1-vjeçar.

c) lëshon Librin për lëvizje me targë prove, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

5. Lëshimi i Librit të lëvizjes me targë provë pasi ka përfunduar, kryhet me kërkesën e aplikantit drejtpërdrejt pranë zyrës së regjistrimit, vetëm nëse ka një autorizim të vlefshëm.

6. Në rastin e humbjes së autorizimit për qarkullim provë, pasi të konfirmohet në sekretari vërtetimi i denoncimit të lëshuar nga organet e policisë për humbjen, lëshohet autorizimi i ri me afat 1-vjeçar, sipas pikës 4.

7. Për çdo targë prove dhe autorizim të lëshuar, të njoftohet DPSHTRR-së me shkrim.

Neni 29

Lëshimi i targës së përkohshme dhe fletudhëtimit

Targa e përkohshme dhe fletudhëtimi lëshohen vetëm për qarkullim të përkohshëm të deklaruar.

1. Aplikanti, që plotëson kushtet e shprehura në nenin 98, pika 1 dhe 2, të ligjit 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për t’u pajisur me targë të përkohshme, dorëzon:

a) aplikimin pranë Drejtorisë Rajonale për shërbimin e kërkuar, i cili përmban dhe Formularin e shërbimit, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

b) deklarata duhet të përmbajë detyrimisht arsyen si edhe itinerarin e lëvizjes nga nisja deri në mbërritje;

c) vërtetim me treguesit teknik të domosdoshëm për identifikim të mjetit, lëshuar nga një servis i licencuar, ku të vërtetohet dhe garantohej siguri për qarkullimin në rrugë për sistemin e frenimit, drejtimit dhe sistemet e tjera të domosdoshme për qarkullim, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

d) kontratën e sigurimit të mjetit, sipas kushteve të marrëveshjes së përbashkët DPSHTRR-AMF.

2. Zyra e regjistrimit:

a) plotëson Regjistrin për targën e përkohshme, sipas modelit të përcaktuar nga DPSHTRR-ja;

b) hedh të dhënat në regjistrin elektronik të mjeteve;

c) plotëson dhe lëshon fletudhëtimin për qarkullim të përkohshëm sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja;

d) lëshon targën e përkohshme;

e) me dokumentet e dorëzuara, krijon dosjen.

Targa e përkohshme dhe fletudhëtimi do të dorëzohen detyrimisht pranë drejtorisë Rajonale. Në rast humbje, vjedhje ose dëmtimi veprohet si për rastet e ngjashme për targat dhe lejen e qarkullimit të përshkruara në këtë udhëzim. Mosdorëzimi përbën shkak për refuzim shërbimi për mjetin dhe për çdo shërbim tjetër për pronarin e identifikuar të mjetit dhe/ose personin që ka aplikuar për shërbim. Për këto të fundit do të njoftohet zyrtarisht edhe Policia e Shtetit ose Drejtoria e Policisë Vendore.



Neni 30

Lëshimi i lejes ndërkombëtare të qarkullimit

1. Për t'u pajisur me leje ndërkombëtare qarkullimi, aplikanti dorëzon:

a) lejen e qarkullimit kombëtare, e cila pas verifikimit i kthehet personit.

2. Zyra e regjistrimit:

a) plotëson Regjistrin elektronik të lejeve ndërkombëtare të qarkullimit.

b) plotëson dhe lëshon lejen ndërkombëtare të qarkullimit me afat vlefshmërie 3 vjeçar, sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja, nëse nuk ka arsye të tjera ligjore për kufizim të këtij afati.

Neni 31

Dispozita të fundit tranzitore

Ngarkohet DPSHTRR për zbatimin dhe plotësimin me aktet e nevojshme të këtij udhëzimi.

Afati i zbatimit të ndryshimeve në formularët e miratuar në këtë udhëzim, si dhe për ndryshimet e nevojshme në sistemin informatik e-DPSHTRR është jo më vonë se data 1 korrik 2019.

Afati i miratimit të formularëve që është ngarkuar DPSHTRR-së për t'i hartuar, është jo më vonë se data 1 korrik 2019.

Udhëzimi nr. 1, datë 18.1.2012 "Për dokumentacionin e qarkullimit dhe regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre" i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 32

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

UDHËZIM

Nr. 19, datë 9.7.2019

PËR MBIKËQYRJEN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE NË FUNKSION TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, paragrafit 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenit 41 të ligjit nr. 8788, datë 17.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim rregullon procedurat që ndiqen nga organet tatimore, si organ mbikëqyrës, për kontrollin e veprimtarisë së OJF-ve, me qëllim shmangien e mundësisë së përdorimit të tyre për pastrim parash apo financim terrorizmi.

Udhëzimi synon unifikimin dhe vendosjen e standardeve bashkëkohore për të garantuar saktësi në dërgimin e informacionit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), me qëllim identifikimin e rasteve të dyshimta për pastrim parash apo financim terrorizmi të OJF-ve.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

"Organizata jofitimprurëse" kuptohen shoqatat, fondacionet dhe qendrat, veprimtaria e të cilave zhvillohet në mënyrë të pavarur dhe pa u ndikuar nga shteti, në përputhje me përkufizimin e dhënë në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", të ndryshuar.

"Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)" kuptohen organizatat e shoqërisë civile, të cilat



mund të jenë organizata jofitimprurëse ose entitete të tjera të shoqërisë civile, që nuk janë regjistruar si OJF, por që ushtrojnë veprimtari në të mirë dhe interes të publikut, në përputhje me përkufizimin e dhënë në ligjin nr. 119/2015 “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për shoqërinë civile”.

“Pastrim parash” është qarkullimi dhe riciklimi i parave, të cilat burojnë nga vepra penale sikurse dhe ndryshimi, transmetimi, transformimi dhe tjetërsimi i produkteve dhe i pasurive që burojnë nga vepra penale, që synojnë fshehjen e burimit të paligjshëm të origjinës, sipas kuptimit të dhënë në nenin 287 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

“Burim i financimit” konsiderohen të ardhurat e organizatës jofitimprurëse sipas përcaktimeve të nenit 35 të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

“Financim i terrorizmit” ka të njëjtin kuptim si në nenin 230/a deri në 230/d të Kodit Penal.

“Njësi qendrore” ka të njëjtin kuptim si në udhëzimin nr. 16, datë 16.2.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”.

“Raportim rasti” është plotësimi dhe përcjellja e Raportit të Aktivitetit të Dyshimtë (RAD-it), formularit në aneksin II bashkëlidhur udhëzimit nr. 16, datë 16.2.2009 të Ministrisë të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”.

“Veprimtari ekonomike” kuptohet veprimtaria e organizuar nga një organizatë jofitimprurëse, me qëllim nxjerrjen e të ardhurave në këmbim të ofrimit të shërbimeve apo të mallrave të ofruara, për të mundësuar misionin e organizatës, me kushtin që veprimtaria ekonomike nuk përbën qëllimin parësor të organizatës, si dhe të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit, në përputhje me përkufizimin e dhënë në ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

Neni 3

Regjistrimi dhe çregjistrimi i OJF-ve

Organizatave jofitimprurëse regjistrohen në administratën tatimore, pasi kanë kryer më parë regjistrimin në gjykatë, në përputhje me legjislacionin e fushës.

Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse bëhet në Drejtorinë Rajonale Tatimore të juridiksionit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Çregjistrimi i organizatave jofitimprurëse bëhet nga gjykata sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 4

Raportimi periodik për OJF-të

Drejtoritë Rajonale Tatimore të juridiksionit identifikojnë dhe raportojnë çdo gjashtë muaj pranë Njesisë qendrore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me OJF-të që zhvillojnë aktivitet pa u regjistruar, OJF-të me status pasiv dhe OJF-të që nuk dorëzojnë deklaratat tatimore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Njësia qendrore në DPT i dërgon DPPPP-së, brenda 15 ditësh nga marrja e informacionit, rastet e identifikuara, e cila kryen një analizë më të thelluar të rastit.

Nëse DPPPP zbulon informacione shtesë të lidhura me rastet e dërguara nga DPT, duhet ta dërgojë për ndjekje të mëtejshme pranë Njesisë Qendrore në DPT, e cila pasi e trajton dhe analizon rastin, bën referimin e tij në rrugë administrative ose penale.



Neni 5

Mbajtja dhe administrimi i dokumentacionit

Drejtoria Rajonale Tatimore të juridiksionit administrojnë në dosjet e OJF-ve të regjistruara, të gjithë dokumentacionin e themelimit, të regjistrimit, të ndryshimeve pas regjistrimit si dhe dokumentacionin tatimor të parashikuar nga legjislacioni tatimor në fuqi dhe ligji nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar.

Dosjet e OJF-ve mbahen në një seksion të veçantë të arkivit të Drejtorisë Rajonale Tatimore.

Rregullat e hollësishme të mbajtjes dhe administrimit të të dhënave të OJF-ve nga ana e Drejtorive Rajonale Tatimore përcaktohen me rregullore, e cila miratohet brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Neni 6

Kontrolli në terren i OJF-ve

Strukturat e verifikimit dhe kontrollit të administratës tatimore, sipas kompetencës territoriale dhe juridiksionit, evidentojnë OJF-të që ushtrojnë aktivitet në territorin e tyre dhe kontrollojnë periodikisht regjistrimin në organin tatimor, përditësimin e të dhënave të regjistrimit, deklarimin e të punësuarve, si dhe zhvillimin e veprimtarisë ekonomike konform kërkesave ligjore në fuqi.

Neni 7

Kontrolli i pasqyrave financiare të OJF-ve

Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) të juridiksionit ngarkojnë punonjës të specializuar dhe të trajnuar për shqyrtimin e pasqyrave financiare të OJF-ve, në varësi të numrit të OJF-ve që administrojnë, të cilët analizojnë veçanërisht, por pa u kufizuar në:

- a) burimet e financimit të OJF-së;
- b) veprimtarinë ekonomike të OJF-së, nëse zhvillon veprimtari ekonomike;
- c) përdorimin e fondeve dhe mënyrën e qarkullimit të tyre;
- d) asetet e OJF-së dhe burimin e krijimit të tyre.

Drejtoria Rajonale Tatimore të juridiksionit informojnë “Njësinë qendrore” në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për OJF-të që nuk kanë dorëzuar pasqyrat financiare dhe gjithashtu për masat administrative të ndërmarra ndaj tyre.

Për rastet e financimeve që paraqesin risk bazuar në tipologjitë e shtojcës bashkëlidhur udhëzimit nr. 16, datë 16. 2.2009 të ministrit të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave” dhe të indikatorëve të shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, i kërkojnë strukturave të kontrollit në DRT ushtrimin e kontrollit të thelluar operacional.

Neni 8

Kontrolli operacional i OJF-ve

Organet tatimore të juridiksionit, strukturat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, ushtrojnë kontroll të thelluar operacional ndaj OJF-ve, sipas përcaktimit paragrafin e fundit të nenit 7, të këtij udhëzimi. Gjatë kontrollit operacional duhet të mbahen parasysh sa më poshtë, por jo vetëm:

1. Evidentimi i burimeve të financimit, marrëveshjet për grantet e përfituara, marrëveshjet për dhurimet dhe donacionet, dokumentimi i kuotave të anëtarësisë;
2. Verifikimi nëse OJF-ja realizon veprimtari ekonomike dhe nëse ka të ardhura nga kjo veprimtari;
3. Verifikimi i deklarimit pranë organit tatimor të numrit të llogarisë bankare ku i kalojnë donacionet;
4. Verifikimi i faktit nëse fondet e organizatave jofitimprurëse mbahen në llogari bankare dhe nëse transferimi apo transaksionet financiare në lidhje me këto fonde kryhen nëpërmjet sistemit bankar, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;
5. Kryerja e detyrave nga organi më i lartë vendimmarrës, bordi i drejtorëve apo mbledhja e përgjithshme e anëtarëve, sipas nenit 20 të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" në lidhje me:
 - a) miratimin e pasqyrave financiare të paraqitura nga organi ekzekutiv;
 - b) mbikëqyrjen e organizatës jofitimprurëse, me qëllim parandalimin e përdorimit të burimeve



të organizatës për qëllime terroriste, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

c) marrëveshjet për grantet, dhurimet dhe donacionet;

ç) verifikimi nëse fondet e grumbulluara janë përdorur për qëllimin e deklaruar.

6. Nëse organizatat jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtari ekonomike dhe realizojnë fitime, i përdorin ato për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit.

Neni 9

Raportimi i rasteve të dyshimta

Drejtoritë Rajonale Tatimore të juridiksionit, nëse gjatë punës së tyre në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim, identifikojnë raste të financimeve që paraqesin rrezik sipas tipologjisë së shtojcës 1 bashkëlidhur udhëzimit nr. 16, datë 16.2.2009 të ministrit të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave” dhe të indikatorëve të shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, brenda 15 ditëve i raportojnë rastet e dyshimta të konstatuara të përdorimit të OJF-ve për pastrim parash apo financim terrorizmi në Njësine qendrore në DPT, sipas përcaktimeve të udhëzimit të sipërpërmendur.

Njësia qendrore në DPT pasi e vlerëson rastin, ia përcjell atë DPPP-së në përputhje me përcaktimet e nenit 18 të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar.

Neni 10

Bashkëpunimi ndërinstytucional

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave:

1. Një herë në çdo gjashtë muaj, shkëmbejnë të dhëna në lidhje me:

a) gjetjet nga kontrollet tatimore për OJF-të;

b) të dhëna për OJF-të që kryejnë transaksione të dyshimta;

c) evidentimin e risqeve në fushën tatimore dhe atyre të PP/FT.

2. Një herë në vit përditësojnë tipologjitë e dyshimta për OJF-të si vijon:

a) nga gjetjet dhe investigimet e përbashkëta;

b) bazuar në shkeljet e indikatorëve të riskut;

c) nga kontrollet e përbashkëta;

ç) nga manuale/rregullore të ndryshme kombëtare/ndërkombëtare, të cilat janë të miratuara nga institucione të specializuara në fushën e PP/FT.

3. Evidentojnë OJF-të me risk bazuar në shkëmbimet e informacioneve të vijueshme midis tyre. Ky material është konfidencial dhe mbahet për nevoja pune nga ana e Drejtorive përkatëse.

4. Nxjerrin rregullore të përbashkët për evidentimin dhe detajimin e pikave të këtij udhëzimi dhe e përditësojnë atë sa herë është e nevojshme. Kjo rregullore është e brendshme dhe shërben vetëm për orientimin e punës së Drejtorive përkatëse.

5. Publikojnë zyrtarisht raporte vjetore mbi problematikat e konstatuara në OJF-të dhe japin statistika të përgjithshme mbi rastet e trajtuara, masat e marra, gjetjet etj. Këto publikime kanë efekt informues për publikun, por asnjëherë nuk ekspozojnë informacione konfidenciale të OJF-ve të dyshimta.

Neni 11

Konfidencialiteti

Informacioni i siguruar nga organi tatimor si organ mbikëqyrës është konfidencial në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Çdo punonjës i administratës tatimore dhe DPPP që ka akses në të dhënat personale që përpunohen në kuadër të këtij udhëzimi, ka detyrimin që të nënshkruajë deklaratën e konfidencialitetit, e cila administrohet nga Institucionet përkatëse në cilësinë e punëdhënësit.

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi zyrtarët ose punonjësit nuk janë më të punësuar nga organi tatimor dhe DPPP.

Informacioni i shkëmbyer ndërmjet të dy institucioneve kryhet mbi bazat e konfidencialitetit reciprok.



Neni 12

Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat personale të individëve të përfshirë në procesin e mbikëqyrjes nga organet tatimore dhe DPPPP, me qëllim shmangien e mundësisë së përdorimit të tyre për pastrim parash apo financim terrorizmi, përpunohen vetëm për qëllim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në rastet kur, në zbatimin e këtij ligji, konstatohet mosrespektimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 13

Indikatorët e aktivitetit të dyshimtë për OJF-të

Veç rasteve të financimeve që paraqesin risk bazuar në tipologjitë e shtojcës 1 bashkëlidhur udhëzimit nr. 16, datë 16. 2.2009 të Ministrit të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi evidentohen indikatorët e riskut të financimit të terrorizmit që lidhen me OJF-të.

Në çdo kontroll operacional që do të ushtrohet nga administrata tatimore, do t'i jepet vëmendje e veçantë këtyre indikatorëve dhe për çdo dyshim rasti do të raportohet sipas përcaktimeve të nenit 9 të këtij udhëzimi pranë DPPPP-së.

Neni 14

Dispozita të fundit

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi nr. 22, datë 19.11.2014 i ministrit të Financave, “Për mbikëqyrjen e OJF-ve, nga organet tatimore, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

SHTOJCA 1

**INDIKATORËT E RISKUT TË
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT QË
LIDHEN ME SEKTORIN E OJF-ve:**

1. Përdorimi i korrierëve të mjeteve monetare për transferimin e fondeve të OJF-ve në zona me aktivitet të njohur terrorist;
2. Transaksionet e copëzuara të OJF-ve, për të shmangur raportimin nga subjektet financiare;
3. Raste kur kërkesat për transferimin e fondeve të OJF-ve shoqërohen me justifikime të paqarta;
4. OJF-të sigurojnë financim nga organizata apo kompani fiktive;
5. Përfaqësuesit e OJF-ve nuk bëjnë deklarimin e vlerave monetare, instrumenteve të negociueshme apo gurëve/metaleve të çmuara në pikat e kalimit të kufirit;
6. Llogaritë bankare të OJF-ve përdoren nga subjekte ndaj të cilëve zbatohen sanksione;
7. Fondet e OJF-ve u transferohen subjekteve që besohet të jenë të angazhuara në aktivitete terroriste;
8. OJF-të marrin fonde nga subjekte që besohet se mbështesin aktivitete terroriste;
9. Fondet e OJF-ve bashkohen me fonde personale apo nga burime të biznesit;
10. Fshehja e llogarive bankare që lidhen me programe apo aktivitete të caktuara;
11. Fondet e OJF-ve u transferohen subjekteve që nuk janë të lidhura me programet ose aktivitetet e deklaruar;
12. Objektet e OJF-ve frekuentohen nga individë që besohet të mbështesin aktivitete terroriste;
13. OJF-të prokurojnë mallra me përdorim të dyfishtë;
14. Burimet e një OJF-je sigurojnë ose transferojnë fonde nga/drejt një subjekti që njihet për angazhimin në aktivitete terroriste apo mbështetjen e tyre;



15. OJF-të ndajnë pronën e tyre me një organizatë që besohet të mbështesë aktivitetin terrorist;

16. OJF-të që nëpërmjet aktivitetit të tyre ofrojnë mbështetje për individë ose organizata, identiteti i të cilëve korrespondon me ato të subjekteve të listuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;

17. Ekzistenca e informatave të besueshme që tregojnë se një OJF apo përfaqësues të saj janë të lidhura me palët e treta që mbështesin ose janë të angazhuar në veprimtari terroriste;

18. Subjektet që veprojnë në zonat me aktivitete të njohura terroriste, depozitojnë fonde në llogaritë bankare të një OJF-je, drejtuesve ose punonjësve të saj;

19. OJF-të transferojnë burime ose kryejnë aktivitete në një zonë ku subjektet terroriste njihen të kenë një prani të konsiderueshme;

20. Të dhënat e OJF-ve mbahen në një zonë me prani të njohur të organizatave terroriste;

21. Përfaqësuesit e OJF-ve, udhëtojnë shpesh në zona ku subjektet terroriste kanë një prani të konsiderueshme;

22. OJF-të kanë aktivitete, programe apo partnerë të paraportuar;

23. OJF-të përdorin një rrjet të pazakontë financiar për realizimin e operacioneve të tyre;

24. OJF-të shmangin kërkesat e raportimit të detyrueshëm;

25. Shpjegimet për programet dhe aktivitetet e OJF-ve tek organet mbikëqyrëse ose rregullatore, janë të paqarta;

26. Palët e treta përdoren për të hapur llogari bankare të OJF-ve ose për të kryer transaksione në emër të tyre;

27. Shpenzimet e OJF-ve nuk janë në përputhje me programet dhe aktivitetet e saj;

28. OJF-ja nuk është në gjendje të ofrojë të dhëna për të ardhurat dhe përdorimin e burimeve të saj;

29. Të dhëna publike për angazhimin e OJF-ve në aktivitete që lidhen me terrorizmin;

30. OJF-të bashkohen me një organizatë tjetër që besohet të mbështesë aktivitete terroriste;

31. Asistenca humanitare e OJF-ve synon të mbështesë individët e lidhur direkt me subjektet terroriste;

32. Drejtuesit e një OJF-je, janë ose kanë qenë drejtues apo punonjës të organizatave të tjera që besohet se mbështesin aktivitetin terrorist;

33. OJF-të vuajnë nga një konflikt i brendshëm, ku një fraksion është i njohur të jetë dashamirës ose të përkrahë në mënyrë aktive subjekte terroriste;

34. OJF-ja ka mospërputhje në raportimin e saj të pasqyrave financiare dhe raporteve të tjera të detyrueshme;

35. OJF-të kanë ndryshime të shpeshta në strukturën drejtuese/vendimmarrëse;

36. OJF-të ose përfaqësuesit e tyre përdorin dokumente të falsifikuara;

37. OJF-të mbështesin terrorizmin ose subjektet terroriste nëpërmjet publikimeve ose predikimeve të përfaqësuesve të tyre;

38. Drejtuesit ose punonjësit e një OJF-je, angazhohen në aktivitete që mbështesin rekrutimin e personave për zonat ndërkombëtare të konflikteve.

KËRKESË

Nr. 4424/2, datë 4.7.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Mbrojtjes shpall kërkesën për shpronësim, “Për zbatimin e ligjit nr. 10256, datë 25.3.2010 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë “Për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendpreshjes për ta brenda territorit të Republikës së Shqipërisë”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni pronarin e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë e paluajtshme, pronë private, e cila do të kompensohet sipas vlerësimit paraparak të llogarit, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 448,000 (katërqind e dyzet e tetë mijë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I MBROJTJES
Petro Koçi



TABELA PARAPRAKE E PRONARIT, PËR PASURINË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN SI PASOJË E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 10256, DATË 25.3.2010 "PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË GREQISË
 "PËR KËRKIMIN, ZHVARRIMIN, IDENTIFIKIMIN DHE VARRIMIN E USHTARAKËVE GREKË, TË RËNË NË SHQIPËRI GJATË LUFTËS GREKO-ITALIANE TË VITEVE 1940-1941 DHE PËR NDËRTIMIN E VENDPREHJES PËR TA BRENDA TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Nr.	Emër Mbiemër	Adresa	Lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. totale arë (m ²)	Sip. Arë e prekur (m ²)	Çmimi arë (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Sip. totale e ndërtësës me certifikatë (m ²)	Sip. e prekur e ndërtësës (m ²)	Vlera e ndërtësës me preventiv (lekë)	Vlera e përgjithshme (lekë)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Shoqëria "Treveshina" sh.p.k.	Këlcyrë, Përmet	Arë	2131	364/20	5000	1845	112	206,640				206,640	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 14.5.2019
2	Shoqëria "Treveshina" sh.p.k.	Këlcyrë, Përmet	Arë	2131	364/21	5000	2155	112	241,360				241,360	Konfirmuar nga ZVRPP-ja më datë 14.5.2019
Vlera paraprake e shpronësimit							4000	112	448,000		-	-	448,000	

**KËRKESË****Nr. 5068/4, datë 8.7.2019****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Sistemimi i Sheshit pas Pallatit nr. 23”, Lushnjë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Lushnjë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personin e prekur nga ky shpronësim,

për pasurinë e paluajtshme, pronë private, i cili do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 626 780 (gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT: SISTEMIMI I SHESHIT
PAS PALLATIT NR. 23”, LUSHNJË

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqe shpronësimi tokë truall m ²	Çmimi tokë truall/m ²	Vlera totale/lekë	Shënime konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
1.	Mimoza Hyqmet Nushi	8572	9/264	70	70	8,954	626,780	Konfirmuar nga ZVRPP me shkresën nr. 5532/1, prot., datë 5.4.2019
	Vlera totale e shpronësimit						626,780	

NJOFTIM**Nr. 9852, datë 4.7.2019****PËR HYRJE NË FUQI TË
MARRËVESHJES**

Amendimi i Kigalit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”, ratifikuar me ligjin nr. 91/2018, për Shqipërinë ka hyrë në fuqi në datën 18.1.2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 252 lekë